



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

---

V E N D I M

Nr. 1439, datë. 03.11. 2010

Për

« Disa ndryshime në VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonise fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 03.11. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Disa ndryshime në VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonise fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse.**

**BAZA LIGJORE :**

1. Neni 12, neni 121 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
2. Neni 31 e vijues, 39 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
3. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010; e ndryshuar.

4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

### **K Ë SHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendim nr.1436, datë 03.11.2010 « Për disa ndryshime në VKD nr. 1345, datë 23.07.2010 “ Shqyrtimin e ankimit administrativ të AMC sh.a., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1210, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit AMC sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.
2. Vendim nr.1437, datë 03.11.2010 « Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 “ Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone sh.a., për ndryshim të aktit administrativ, Vendim nr.1211, datë 31.03.2010 të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.
3. Vendim nr.1438, datë 03.11.2010 « Për disa ndryshime në VKD nr. 1346, datë 23.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

Si dhe,

4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;
5. Analizës së fakteve në referencë me bazën ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

**I.** Me Vendimin nr. 1348 , datë 23.07.2010 Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur të përcaktojë sipërmarrësin Altelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakice të telefonise fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonise fikse. Nëpërmjet këtij vendimi AKEP vendosi që duke filluar nga data 1.11.2010, tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Altelecom të jetë objekt i negociatave komerciale, në ndryshim nga detyrimi i kontrollit ex-ante i kësaj tarife deri në këtë datë. Ky vendim i AKEP, për këtë çështje, u morr në vijim të vendimeve nr.1345, nr.1346 dhe nr.1347, datë 23.07.2010, për operatorët celularë, me qëllim trajtimin e njëjtë të rregullimit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në të gjitha rrjetet e operatorëve me FNT.

**II.** Me VKD nr. 1436, datë 03.11.2010, VKD nr. 1437, datë 03.11.2010, meqenëse :

1. Sipërmarrësi Vodafone sh.a., dhe AMC sh.a., tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare edhe pse në terma komerciale nuk e kanë negociuar atë me sipërmarrësit e interesuar në mënyrë transparente duke dhënë shpjegime dhe argumenta për nivelin e saj, me qëllim që të vërtetojnë se është një tarifë e arsyeshme, e orientuar drejt kostos, jo abuzive,

konkurrese dhe e pranueshme nga palët e interesuara gjithashtu brenda interesit të tyre të arsyeshëm komercial, detyrim ky që buron nga pika 1 e nenit 53 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ku kërkohet që “Në përcaktimin e tarifave të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, sipërmarrësit duhet të synojnë orientimin e tarifave drejt kostos dhe në çdo rast sipërmarrësit duhet të shmangin përdorimin e tarifave abusive, shpërdoruese dhe antikonkurrese”;

2. Oferta e paraqitur nga Vodafone sh.a., dhe AMC sh.a., lidhur me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në vlerë krahasuar me nivelin e tarifave analoge të publikuara në bursën ndërkombëtare për këtë qëllim është më e lartë se tarifat mesatare të vendeve të BE-së, duke çenuar në këtë mënyrë përcaktimin ligjor të parashikuar në shkronjën c) të nenit 8 të ligjit nr. 9918;

3. Sipërmarrësit Vodafone sh.a., dhe AMC sh.a., duke qënë në kushtet e mospranimit nga ana e sipërmarrësit Albtelecom si dhe sipërmarrësit e tjerë, të kësaj tarife të imponuar prej tyre dhe jo të negociuar, në mënyrë të menjëhershme, pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 1345, nr.1346, nr.1347 datë 23.07. 2010 të KD të AKEP më datë 01. 11. 2010 për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, pa pritur që AKEP të dalë me vendimin përkatës kundrejt ankimeve të paraqitura nga sipërmarrësit më sipër thënë, kanë vepruar në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare, me ndërprerjen e ofrimit e shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ndaj këtyre sipërmarrësve, duke çenuar në këtë mënyrë detyrimet e përcaktuara nga AKEP me vendimet Nr. 1210, 1211, 1212 datë 31.03.2010 dhe Nr. 1345, 1336, 1347 datë 23.07.2010 për aksesin dhe interkoneksionin në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 9918;

4. Sipërmarrësit me FNT – Vodafone sh.a., dhe AMC sh.a nuk arritën të administrojnë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme heqjen e masës rregullatore për rregullimin *ex-ante* të tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe përcaktimin e saj nëpërmjet negociimit në terma komerciale të pranueshme në mënyrë të dyanshme, çka bëri që duke patur parasysh mosmarrëveshjet e depozituara së fundmi në AKEP nga sipërmarrësit e interesuar, lidhur ngushtësisht me aplikimin e tarifave për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, si dhe detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 49, pikën 2 dhe 3 të nenit 53 dhe 55 të ligjit nr. 9918, në zbatim të kompetencave të përcaktuara të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues, në ushtrim të pushtetit diskrecial ka vendosur të ndryshojë VKD nr 1345, dhe VKD nr.1347, date 23.07.2010. Gjithashtu bazuar në parimin e drejtësisë, barazisë dhe paanësise, në mënyrë analoge të rregullimit AKEP ka ndryshuar edhe VKD nr. 1346, datë 23.07.2010 për sipërmarrësin Eagle Mobile Sh.a.

**III.** Për shkak të ndryshimit të vendimeve nr.1345, nr.1346 dhe nr.1347, datë 23.07.2010, për rregullimin e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare e FNT, del e nevojshme ndryshimi i vendimit nr.1348, datë 26.07.2010, në lidhje me trajtimin e rregullimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin Albtelecom.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Këshilli Drejtues i AKEP, në ushtrim të funksioneve të tij , duke treguar kujdes të veçantë për trajtimin në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të të gjithë sipërmarrësve, mbështetur në parimin e mosdiskriminimit , bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

## V E N D O S:

1. Në VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 “ Për përcaktimin e sipërmarresit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse ”:
  - i. Shkronja ii), e nën pikës 4.5.1 të pikës 4 - pjesa “Vendos”, të ndryshojë dhe bëhet si më poshtë vijon:
    - Objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP sipas pikave 4.5.2 dhe 4.5.3, për shërbimet e terminimit në rrjetin Albtelecom të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcjella nga operatorët e autorizuar nga AKEP;
  - ii. Në shënimet e Tabelës tek shkronja ii) e nën pikës 4.5.2 të pikës 4 - pjesa “Vendos”, të shtohet shënimi 3 si vijon:
    - Tarifa maksimale për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të përcjella nga operatorët e autorizuar nga AKEP, të jete e njëjtë me tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare
  - iii. nën-pika 8.3 e pikës 8 tek pjesa “Vendos”, shfuqizohet.
3. Të gjitha përcaktimet e tjera të VKD nr, 1348, datë 26.07.2010, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Formatted: Font: 12 pt

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI** .
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**